



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:241245

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05422329

C.nr.1007/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.K nga fshati Retijë, Komuna e Rahovecit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati D.M nga Rahoveci, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, me bazë juridike kompensimi i ushqimit në punë, vlera e objektit të kontestit 548.00 euro, jashtë seancës, më datën 07.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit F.K.

DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit F.K nga fshati Retijë, Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 18.04.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 274 ditë pune të ja paguajë shumën prej 548.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 03.11.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit F.K, t’i paguajë shumën prej 125.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi F.K, më datën 03.11.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ka parashtruar padinë për kompensimin e ushqimit në punë në shumën prej 548.00 euro.

I njëjti sipas padisë ka theksuar se është në marrëdhënie pune si mësimdhënës në SHMFU “Haki Stërmilli”, në fshatin Zoqishtë, Komuna e Rahovecit, ku edhe është duke punuar në këtë institucion, e që duke llogaritur për periudhën kohore nga data 18.04.2021 deri më 21.11.2022, paditësit i takon e drejta e kompensimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, shuma prej 2 euro, por që deri më tani nuk është kompensuar. Në bazë të lartcekurave dhe duke u bazuar në

dispozitat e Ligjit të punës përkatësisht nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 21.01.2021, e cila përcakton kompensim për ushqim gjatë punës. Andaj, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 07.02.2024, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi, padia e paditësit nuk ka bazë të qëndrueshme ligjore, ashtu që e drejta e kompensimit mbi bazën në të cilën është thirrur pala paditëse rezulton se është e pavlefshme. Paditësi ka ushtruar padi në gjykatë me 03.11.2023, me të cilën ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 18.04.2021 – 21.11.2022, me mbështetjen në Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021. Duke shtuar se kërkesëpadinë e konteston në tërësi edhe mbi bazën se më 21.11.2022 MASHT-i, ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Më tej ka shtuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, është parashkruar. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 1345/2, i datës 12.07.2023, i lëshuar nga SHFMU “Haki Stërmilli” në fshatin Zoqishtë dhe kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 679/2, e datës 04.09.2019, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit F.K.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësi për periudhën e kërkuar kohore ka prezantuar në punë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësit pagesa e ushqimit për çdo ditë të prezencës në punë, dhe a është parashkruar e drejta për të kërkuar kompensimin e ushqimit.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr.1345/2, i datës 12.07.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësi F.K, në periudhën kohore prej datës 18.04.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 274 ditët e punës.

Me administrimin e kontratës e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 679/2, e datës 04.09.2019, të lidhur ndërmjet paditësit F.K dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Haki Stërmilli” në fshatin Zoqishtë, Komuna e Rahovecit.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit për faktin se paditësi në periudhën kohore nga data 18.04.2021 e deri më datën 21.11.2022 në vendin e tij të punës ka prezantuar në 274 ditët e punës. Kjo është vërtetuar sipas vërtetimit të lëshuar nga vetë shkolla ku paditësi ka qenë duke punuar, ndërsa vërtetësinë e këtij dokumenti nuk e ka kontestuar as e paditura. Baza juridike e kërkesëpadisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Ndërsa sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore”*. Në rast se shumëzohen 274 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro të paditësit F.K, për secilën ditë të prezencës në punë, do të kemi shumën e përgjithshme prej 548 euro.

Sa i përket çështjes së parashkrimit, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës për faktin se padia e paditësit është dorëzuar më datën 03.11.2023, ndërsa kërkesëpadija e paditësit përfshin periudhën kohore prej datës 18.04.2021 e deri më datën 21.11.2022.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Vendimin lidhur me kumatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil  
C.nr.1007/2023, më datën 07.03.2024

Bashkëpunëtorja profesionale  
Adelina Çmega

Gjyqtari  
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.